

DEKLARATË

PËR PRIVATËSI GJATË KRYERJES SË VIDEOMBIKËQYRJES

Kjo deklaratë për privatësi shpjegon llojin e të dhënave personale që Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut (në tekstin e mëtejme: kontrolluesi) mbledh nga ju gjatë vizitës së hapësirave zyrtare dhe mënyrën e përdorimit të tyre nga ana e kontrollorit.

1. Pse kontrolluesi mbledh (përpunon) të dhëna personale?

Kontrolluesi mbledh të dhëna personale përmes sistemit të videombikëqyrjes për arsyet (qëllimet) e mëposhtme:

- Të kontrollojë aksesin në objekt (ndërtesë, hyrje, hapësira, etj.) dhe të sigurojë sigurinë e objektit të kontrolluesit, sigurinë e punonjësve dhe vizitorëve, si dhe pronën dhe informacionet që ndodhen ose ruhen në objekt;
- Të parandalojë, pengojë dhe nëse është e nevojshme, të hetojë aksesin e paautorizuar fizik, duke përfshirë aksesin e paautorizuar në mjediset e siguruara dhe të mbrojtura, infrastrukturën e IT-së ose informacionin operacional; dhe,
- Të parandalojë, zbulojë dhe hetojë vjedhjen e pajisjeve ose aseteve në pronësi të kontrollorit, vizitorëve ose personelit, ose kërcënimet për sigurinë e personelit që punon në ambiente (për shembull: zjarri, sulmi fizik, etj.).

Sistemi i videombikëqyrjes nuk përdoret për asnjë qëllim tjetër, si për shembull për monitorim të punës së punonjësve apo praninë e tyre. Videokamerat janë të pozicionuara në mënyrë që të mos mbulojnë hapësirën publike përreth. Kamerat synojnë të japin një pasqyrë të përgjithshme të asaj që po ndodh në vende të caktuara, por jo të njohin fytyrat.

Sistemi i videombikëqyrjes gjithashtu nuk përdoret si një mjet hetimor ose për të marrë prova në hetimet e brendshme ose proceset disiplinore, përveç në rast se është incident sigurie për të cilin është vendosur videombikëqyrje në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në rrethana të jashtëzakonshme, të dhënat mund t'u jepen autoriteteve hetuese si pjesë e një hetimi formal disiplinor ose penal).

Kamerat e mbikëqyrjes janë të instaluar në videoregjistrues dhe janë të pozicionuara dhe të fokusuar në mënyrë që të regjistrohen vetëm personat që hyjnë në ambientet (objektet) zyrtare, përfshirë edhe pronën.

Sistemi i videombikëqyrjes mbulon sipërfaqen e: hyrjeve në objektet e Bankës Popullore, duke përfshirë zonën e mbrojtur të oborrit ekonomik dhe pikat e mbetura të hyrjes në garazh dhe bodrum.

2. Çfarë të dhënash mbledh kontrolluesi?

Kontrolluesi mbledh vetëm video nga kamerat dhe nuk kryhet asnjë audio regjistrim.

3. Kush është përgjegjës për përpunimin e të dhënave?

Kontrolluesi është subjekti që kryen përpunimin e të dhënave personale dhe përcakton qëllimet e përpunimit, vetëm në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Po ashtu, personat Branko Momiroski dhe Boshko Millosheski janë persona kontaktues dhe përgjegjës për videombikëqyrje.

4. Cila është baza ligjore për përpunimin e të dhënave personale përmes sistemit të videombikëqyrjes?

Kontrolluesi përdor pajisje të videombikëqyrjes për:

- Mbrojtje të jetës ose shëndetit të njeriut;
- Mbrojtje të pronës;
- Mbrojtje të jetës dhe shëndetit të punonjësve për shkak të natyrës së punës;
- Sigurimi i kontrollit për hyrjen dhe daljen hapësirat zyrtare.

Gjithashtu, në hyrje të objektit është i dukshëm dhe i shfaqur qartë njoftimi i videombikëqyrjes, i cili u mundëson subjekteve të të dhënave personale të njihen me performancën e videombikëqyrjes, si dhe emrin e kontrollorit që kryen videombikëqyrjen dhe mënyrën se si mund të merren informacione ku dhe sa kohë ruhen regjistrimet e sistemit të videombikëqyrjes.

5. Kush mund të shohë informacionin tim personal?

Qasje në video mund të kenë vetëm personat e autorizuar për videombikëqyrje ose administratorët e sistemit të videombikëqyrjes. Qasja në pajisjet digjitale ose në diskun në të cilin ruhen videot është e kufizuar, e mbrojtur me aplikimin e masave teknike të sigurisë së të dhënave (për shembull: fjalëkalim, regjistrim i çdo ngjarjeje ose veprimi nga një person i autorizuar, administrator). Të dhënat, gjegjësisht videot nuk mund të hapen pa autorizim e personave përgjegjës për videombikëqyrje Branko Momiroski dhe Boshko Millosheski.

6. Si mund t'i kontrolloj të dhënat e mia?

Kërkesën mund ta dërgoni tek personi përgjegjës në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri në adresën: Blvd. "Kuzman Josifovski-Pitu" nr. 1 ose me e-mail: dimitrieva@nbrm.mk.

7. A mund të kem qasje në të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të keni qasje në të dhënat tuaja në çdo kohë dhe pa pagesë, duke i dërguar kërkesë personit përgjegjës në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri, ose me e-mail në: dimitrieva@nbrm.mk

8. A mund t'i ndryshoj të dhënat e mia?

Nuk lejohet ndryshim i videove të mbikëqyrjes.

9. A mund të kërkoj kufizim në përpunimin e të dhënave të mia?

Ju keni të drejtë të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale në çdo kohë duke dërguar kërkesë në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri ose me e-mail në: dimitrieva@nbrm.mk, në adresën: Blvd. "Kuzman Josifovski-Pitu" nr. 1, kur kundërshtoni saktësinë e të dhënave tuaja personale, ose kur kontrolluesi nuk ka më nevojë për të dhënat për të kryer detyrat e tij. Ju gjithashtu mund të bllokoni përpunimin kur operacioni është i paligjshëm duke kundërshtuar fshirjen e të dhënave. Megjithatë, bllokimi nuk është i mundur në çdo rast të një hetimi zyrtar.

10. A mund t'i fshij të dhënat e mia?

Ju keni të drejtë të kërkonit fshirjen e të dhënave tuaja në çdo kohë duke dërguar kërkesë në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri ose me e-mail në: dimitrieva@nbrm.mk, në adresën: Blvd. "Kuzman Josifovski-Pitu" nr. 1, kur përpunimi është i paligjshëm.

11. A ndahen të dhënat e mia personale me njerëz të tjerë?

Të dhënat tuaja ruhen nga kontrolluesi, përveç rastit nese kërkonit nga kontrolluesi ose jepet pëlqim që ato të ndahen. Në rast se të dhënat tuaja ndahen me palën e tretë, ju do të njoftoheni se kujt i janë zbuluar ato, për çfarë qëllimi dhe mbi çfarë baze ligjore.

12. A kam të drejtë të kundërshtoj?

Po, ju keni të drejtë në ankësë dhe kundërshtim të përpunimit në çdo kohë duke dërguar kërkesë në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri ose me e-mail në: dimitrieva@nbrm.mk, në adresën: Blvd. "Kuzman Josifovski-Pitu" nr. 1, kur keni arsye legjitime për situatën tuaj të veçantë. Kontrollori do të veprojë sipas kërkesës tuaj brenda 15 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës.

13. Çfarë mund të bëj në rast problemi?

- a) Hapi i parë është të informoni personin përgjegjës në Drejtorinë për mirëmbajtje teknike dhe siguri duke dërguar e-mail në adresën dimitrieva@nbrm.mk dhe të kërkohet nga ai që të ndërmarrë veprime.
- b) Hapi i dytë, nëse nuk merrni përgjigje nga ne ose nëse nuk jeni të kënaqur, kontaktoni zyrën për mbrojtjen e të dhënave personale në numrin e telefonit: 02 3108 233 ose 02 3108 110, e-mail: ozlp@nbrm.mk ose përmes zyrës për gjendje civile në adresën: Blvd. "Kuzman Josifovski-Pitu" nr. 1.
- c) Në çdo kohë mund të parashtroni kërkesë në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale www.azlp.mk, e cila do të veprojë sipas kërkesës tuaj dhe do të marrë masat e nevojshme.

13. Kur do të fillojë përpunimi i të dhënave të mia personale përmes sistemit të videombikqyrjes? Përpunimi fillon në momentin që vizitoni ambientet e kontrollorit.

14. Siguria e të dhënave personale.

Kontrolluesi është i përkushtuar për mbrojtjen e të dhënave tuaja personale. Prandaj, përdor teknologjitë dhe procedurat e sigurisë që mbrojnë informacionin tuaj personal kryesisht nga qasja, përdorimi ose zbulimi i paautorizuar. Ne i ruajmë të dhënat tuaja në një sistem kompjuterik me qasje të kufizuar dhe në një mjedis të kontrolluar.

15. Sa kohë i ruani të dhënat e mia?

Kontrolluesi do të ruajë të dhënat tuaja personale për 30 ditë kalendarike pas vizitës suaj në ambientet tona, pas së cilës të gjitha videot e regjistruara fshihen automatikisht.